



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 206 Prot

Tiranë, më 18/3 /2015

**Lënda:** *Jepet mendim për draft/Strategjinë ndërsektoriale për reformën në Administratën Publike 2015 – 2020*

**Drejtuar:** **Znj. Milena HARITO**  
**MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE**  
**ADMINISTRATËN PUBLIKE**

**TIRANË**

E nderuar znj. Ministre,

Në përgjigje tuajës nr.1127 Prot, datë 06.03.2015, në *draft/Strategjinë ndërsektoriale për reformën në Administratën Publike 2015 – 2020*, sugjerojmë që në *Seksionin "D" "Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja"* pjesa që i takon ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (përmbajtje e evidentuar në faqen nr.17), të zëvendësohet si vijon:

### **E DREJTA E INFORMIMIT**

"Ligji nr 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" synon garantimin e informacionit për publikun për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të individit në praktikë si dhe formimin e pikëpamjeve të publikut për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë, të nxisë integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike.

Ai është një sistem i ri mbikëqyrje i së drejtës për informim, kompetencë e shtuar dhe e atribuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.  
Risitë e këtij ligji janë fokusuar në:

- Përcaktimin e dy kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe me kërkesë;
- Mbrojtjen e së drejtës për informim që ka çdo individ, pa qenë nevoja të sqarojë motivet;
- Rregullimin e njohjes me informacionin/dokumentin zyrtar publik;
- Rregullimin e përgatitjes dhe miratimit të programeve të transparencës;
- Krijimin e një figure të re, siç është koordinatori për të drejtën e informimit, dhe parashikimin e kompetencave të tij;
- Rregullimin e kompetencave dhe procedurave për shqyrtimin e ankesave;

- Parashikimin e kufizimit të së drejtës për informim;
- Parashikimin e shkeljeve dhe sanksioneve administrative.

Në përmbushje të nenit 6 dhe pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” është hartuar dhe miratuar me Urdhrin nr.14, datë 22.01.2015 “Programi Model i Transparencës për Autoritetet Publike” të Komisionerit, standardi i formatit “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve” si dhe të tjerë dokumente rekomanduese për model, set i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të KDIMDP-së si dhe i botuar në *Fletoren Zyrtare Nr 6, datë 28 janar 2015*.

Kjo është një pikënisje e mirë për të ndërgjegjësuar autoritetet publike në tërësi, që brenda afatit gjashtë muaj nga miratimi i ligjit të kenë pasqyruar në faqet e tyre zyrtare, Programet e Transparencës.

Programet e Transparencës janë mjete e mënyra më efikente për të pajisur individin/organizatën, etj, me pjesën më të madhe të informacionit për të cilin ai është i interesuar të informohet apo me veprimtarinë në tërësi të punës që zhvillon një autoritet publik.

Konferenca e trajnime në bashkëpunim me OSFA, janë organizuar për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve dhe në veçanti të Koordinatorëve për rolin e rëndësishëm që kanë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të të drejtës për informim.

Vendimarrjet e Komisionerit derimëntani kanë synuar urdhërimin e autoriteteve publike për respektimin e procedurave ose dhënie dokumenti zyrtar sipas objektit të kërkesës/ankesës.

Risi tjetër për vitin 2014 ishte edhe miratimi me datë 30 tetor 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.” Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, lidhur me procedurën e vendimarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ligji ka parashikuar ankimin pranë **Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** në rast se palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cënuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik.

Shtimi i kompetencave, monitorimi, veprimtaria kontrolluese, puna ndërgjegjësuere apo rekomanduese, etj, diktojnë në të ardhmen shtimin e kapaciteteve njerëzore për Zyrën e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale me 7 deri në 10 punonjës.

## Sfidat

- ✓ Rritja (krijimi) dhe forcimi i kapaciteteve administrative për të mbikëqyrur, monitoruar, koordinuar, hetuar e deri në vendosjen e sanksioneve administrative, sipas ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet investimeve për zhvillimin e infrastrukturës informatike, për krijimin e një ndërveprimi me të gjithë institucionet publike.
- ✓ Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse për informim dhe në të njëjtën kohë për mbrojtjen e privatësisë.
- ✓ Përfitimi i projekteve IPA, me synim përafrimin dhe implementimin e standarteve më të mira në tematika të caktuara për ligjin për të drejtën e informimit.

- Ndërsa, në Planin e Veprimit për periudhën 2016 e në vijim, sugjerojmë të përfshihet rritja e kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me 7 deri në 10 punonjës, me kosto financiare 18 000 në mijë lek/ në vit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

